

# Patriotët e vërtet të Kosovës

## Eko Biznesi

"Pagesa e tatimit është obligim patriotik", theksoi ministri i Ekonomisë dhe i Financave Ahmet Shala, në ceremoninë e dhënies së mirënjohjeve tatimpaguesve më të rregullt. "Para një dekade ka qenë patriotizëm i madh që të mos paguash taksat, pasi ka qenë një kohë e vështirë, kurse në këtë kohë është një gjë shumë e madhe dhe unë e konsideroj patriotizëm nëse i paguajmë shtetit me rregull të gjitha tatimet", ka patur ai. Megjithatë bizneset shpesh ankohen për taksat të larta dhe kushtet jo të favorshme për zhvillimin e biznesit, drejtori i ri i Administratës Tatimore, Behxhet Haliti njoftoi se do të nisnin me pajisjen e bizneseve me numra fiskale dhe me arkë lëvizëse.

"Shumë shpejt do të fillojë edhe vendosja e arkave fiskale dhe kjo do të jetë një mundësi e mirë për tatimpaguesit", ka thënë ai.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Besim Beqaj ka thënë se OEK-u, është angazhuar që ndërmarrjet të disiplinohen sa i përket tatimeve. "Ne po angazhohemi të punojmë bashkë me të gjithë, që Kosova të ec drejt integritimit. Pagesa e taksave dhe obligimeve tjera nga ndërmarrjet, do ta ndihmojnë këtë proces dhe do të bëjnë që vendi të zhvillohet", ka thënë Beqaj.

Drejtesit e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), vunë në dukje se ka pasur shumë biznese, që kanë plotësuar kriteret për t'u nderuar me mirënjohje si tatimpagues të rregullt, mirëpo, numri i mirënjohjeve ishte i kufizuar. "Kemi vendosur që ndërmarrjet e tjera t'i shpërbliejmë gjatë ceremonive të ardhshme", ka thënë Mimoza Kusari Lila, drejtesja e OEAK.

Ndërmarrjet që janë zgjedhur si



Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK), kanë bërë ndarjen e çmimeve për ndërmarrjet që kanë respektuar rregullat dhe kushtet e pagesave të tatimeve. Nga shumë ndërmarrje kosovare që ishin konkurruese, komisioni i përbërë nga zyrtarë të OEK-ut dhe OEAK-t, ka përzgjedhë 12 ndërmarrje që morën epitetin si më të mirat në vend

më të mirat në Kosovë, sa i përket kryerjes së obligimeve ndaj shtetit janë: Banja e Klllokati, Coca Cola HBC, Elting Electronics, Inter-adria, Informatika Computers, Metal Kos, MEKA, Raifesen Bankë, Sharr-Cem, Tracing Group, Warth Kosova. Po ashtu në këtë solemnitet është nënshkruar memorandum i mirëkuptimit mes të drejtorit të Doganave të Kosovës, Naim Huruglicës dhe Kryetares së Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës Mimoza Kusari -Lila.

